

Kuptimi i fjalës teberruk:

Fjala teberruk (?????) gjuhësisht domethënë shtim dhe vazhdimësi e diçkaje.

Kurse, në terminologjinë fetare teberruk domethënë: Kërkimi i bereqetit dhe shpresa në arritjen e tij.

Llojet e teberrukut:

1. Teberruku i ligjësuar (????? ?????).
2. Teberruku i ndaluar (????? ?????).

Teberruku i ligjësuar:

1. Teberruku (kërkimi i bereqetit) nëpërmjet qenies së Pejgamberit Muhamed - sal-lallahu alejhi ue sel-lem - dhe nëpërmjet asaj që shkëputet nga trupi i tij. Ky lloj i teberrukut është i veçantë

për kohën kur ka qenë gjallë Pejgamberi - sal-lallahu alejhi ue sel-lem -, pra ka qenë i lejuar vetëm në atë kohë.

2. Kërkimi i bereqetit me fjalë dhe vepra të ligjësuar, të cilat kur i bën njeriu ka hajr dhe bereqet, siç janë leximi i Kuranit, përmendja e Allahut, prania në vende ku mësohet feja etj.

3. Kërkimi i bereqetit në ato vende që i ka bërë Allahu të bereqetshme, siç janë xhamitë dhe vendet si Meka, Medina dhe Shami.

Me kërkim të bereqetit në këto vende kemi për qëllim bërjen e veprave të mira dhe adhurimin e Allahut në to, duke bërë vepra të ligjësuar e jo duke i prekur muret a shtyllat që gjenden në to.

4. Kërkimi i bereqetit në kohë që i ka veçuar Allahu me vlerë dhe bereqet, sikurse që janë muaji i ramazanit, dhjetë ditët e muajit dhul-hixhxe, Nata e Kadrit, pjesa e tretë e natës etj.

Kërkimi i bereqetit në këto kohë bëhet duke i shtuar punët e hajrit dhe duke e adhuruar Allahun me vepra të ligjësuar.

5. Kërkimi i bereqetit nëpërmjet ushqimeve që i ka bërë Allahu të bereqetshme, siç janë vaji i ullirit, mjalti, qumështi, fara e zezë dhe uji i zemzemit.

Teberruku i ndaluar:

1. Kërkimi i ndaluar i bereqetit nëpërmjet vendeve dhe sendeve:

Shembuj:

- a. Prekja dhe fërkimi i mureve të atyre vendeve, bereqeti i të cilave është vërtetuar sheriatikisht, po ashtu edhe puthja e dritareve dhe shtyllave të atyre vendeve, si dhe kërkimi i shërimit nëpërmjet dheut të tyre.
- b. Kërkimi i bereqetit nëpërmjet varreve të njerëzve të mirë dhe tyrbeve.
- c. Kërkimi i bereqetit nëpërmjet vendeve që kanë të bëjnë me ngjarje historike, siç janë vendi i

lindjes së Pejgamberit Muhamed - sal-lallahu alejhi ue sel-lem -, shpella "Hira", shpella "Theur" etj.

2. Kërkimi i bereqetit nëpërmjet kohëve:

Bërja e veprave që nuk janë të ligjësuara sipas sheriatit dhe ibadeteve të shpikura në ato kohë, bereqeti i të cilave është vërtetuar sheriatikisht.

Kërkimi i bereqetit nëpërmjet atyre kohëve, bereqeti i të cilave nuk është vërtetuar sheriatikisht:

Këtu hyjnë mevludi i Pejgamberit - sal-lallahu alejhi ue sel-lem -, nata e israsë dhe mi'raxhit, nata e mesit të muajit shaban dhe po ashtu ditët dhe netët e ngjarjeve historike.

3. Kërkimi i ndaluar i bereqetit nëpërmjet qenieve të njerëzve të mirë dhe gjurmëve të tyre: Kërkimi i bereqetit nëpërmjet qenies së ndonjë njeriu është i ndaluar. Kjo ka qenë e lejuar të

bëhet vetëm me qenien e pejgamberit Muhamed - sal-lallahu alejhi ue sel-lem - gjatë kohës sa ishte gjallë.

Rregulla të rëndësishme lidhur me teberrukun:

1. Teberruku (kërkimi i bereqetit) është ibadet, ndërsa ibadetet, në thelb, janë të ndaluara, derisa të vijë ndonjë argument që dëshmon se ato janë të ligjësuara.
2. I tërë bereqeti vjen vetëm nga Allahu, Ai është Pronari dhe Ai që e dhuron atë, për këtë arsye nuk bën të kërkohet bereqeti nga dikush tjetër pos Allahut.
3. Kërkimi i bereqetit nëpërmjet atyre gjërave, bereqeti i të cilave është vërtetuar sheriatikisht, u bën mirë vetëm besimtarëve të vërtetë në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij - sal-lallahu alejhi

ue sel-lem.

4. Kërkimi i bereqetit nëpërmjet atyre gjërave, bereqeti i të cilave është vërtetuar shariatikisht, duhet të bëhet në mënyra të ligjësuara dhe të mos shpiken mënyra që nuk i kanë bërë selefët (të parët tanë të devotshëm).

Shkëputur nga libri “Et-Teuhijd el-mujesser” i autorit Abdullah El-Huvejl
Përktheu: Jusuf Kastrati – Shembulli.com